



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr. 372/20

Datë: 01.10.2020

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 10 pika 6 e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, UA të MASHT-it Nr.34/2014 , Vendimit të Qeverisë Nr.01/27 të datës 26.08.2020 për Aprovimin e Master Planit nga MASH dhe UA-MASHT Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, shpall këtë:

K O N K U R S

Për kryerjen e punëve me kontratë për kohë të caktuar (detyra specifike)

Nr.	Niveli	Pozita	Kohëzgjatja e shërbimit	Nr. pozitave
1.	SHFMU	Gjuhë Angleze	4 (katër) muaj.	2
2.	SHFMU	Gjuhë Shqipe	4 (katër) muaj.	2
3.	SHFMU	Histori	4 (katër) muaj.	1
4.	SHFMU	Artë Figurativ	4 (katër) muaj.	1
5.	SHFMU	Biologji	4 (katër) muaj.	1
6.	SHFMU	Matematikë	4 (katër) muaj.	1
7.	SHFMU	Psikolog/e	4 (katër) muaj.	3
8.	SHFMU	Punëtor teknik	4 (katër) muaj.	2
9.	SHFMU	Mesimdhënës/e të mesimit klasor (1-5)	4 (katër) muaj.	3
10.	SHFMU	Edukatore për parashkollor	4 (katër) muaj.	1
11.	IP	Edukatore	4 (katër) muaj.	1
12.	IP	Motër Edukatore	4 (katër) muaj.	1
13.	SHFMU	Gjuhë Frengje	4 (katër) muaj.	1
14.	SHFMU	Tik	4 (katër) muaj.	2
15.	SHFMU	Mjek specialist ose Mjek i Përgjithshëm	4 (katër) muaj.	1
16.	SHFMU	Asistente për fëmijet me nevoja të veqanta	4 (katër) muaj.	2

Paga mujore për mesimdhënës/e **400 Euro**

Paga mujore për asistent për fëmijë me nevoja të veqanta **350 Euro**

Paga për punëtor teknik **250 Euro**

Orari i plotë i punës 40 orë në javë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Certifikata e lindjes, jo më e vjetër se 6 muaj,
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës, e vërtetuar, jo me e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t' i kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se 6 muaj
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor,administrativ dhe teknik.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr.03/L.068 dhe Ligjit Nr.04/L-032) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr.10/2018) UA të MASHT-it Nr.34/2014 si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik kandidatët do t' i nënshtrohen testimit me shkrim. Testimi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlersimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë se paku 50% të pikëve nga testi me shkrim i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë kandidatët mund të vlerohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlersimit përfundimtar.

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 01.10.2020 deri me datën 08.10.2020.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhës dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjtën zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje. Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë.

Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit, ndërsa i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet.

Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrin pas afatit nuk do të shqyrtohet.

Gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.

